



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR TË DREJTEN E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN E TË
DHËNAVE PERSONALE

Nr. 533 / Prot.
6

Tiranë, më 28/6 /2016

REKOMANDIM

Nr. 14, datë 28/6 /2016

Në mbështetje të neneve 29, 30, 31 dhe 32 të ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale", i ndryshuar, si dhe neneve 77-97 të Ligjit 44/2015, datë 30.05.2015 "Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë", si dhe provave në ngarkim të kontrolluesit "KLAN TV".

KONSTATOVA:

Në zbatim të Urdhrit nr. 136, datë 19/05/2016 të Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, u krye hetimi administrativ pranë kontrolluesit "KLAN TV", me objekt:

- Verifikimi i ankesës së paraqitur pranë Zyrës së Komisionerit nga personi me initiale E.M. nr. 533 prot, datë 09.05.2016, në kuadër të verifikimit të ligjshmërisë së përpunimit të të dhënave personale gjatë transmetimit të emisionit "E Diela Shqiptare" të datës 17.04.2016, në zbatim të Ligjit nr. 9887, datë 10/03/2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale" i ndryshuar;

Hetimi administrativ pranë kontrolluesit është iniciuar mbi bazën e ankesës së paraqitur nga personi me initiale E.M. nëpërmjet të cilës pretendonte se në rubrikën "Shihemi në Gjyq" (drejtuar nga Znj. Eni Çobani) të emisionit "E diela Shqiptare", të datës 17.04.2016, në Televizionin KLAN, me palë një çift bashkëshortësh, janë publikuar fakte apo rrethana nga jeta e saj, pa marrë pëlqimin e kësaj të fundit.

Pala ankuese ka paraqitur bashkëlidhur ankesës edhe një fotokopje të dokumentit të identitetit shoqëruar me fotografi (kartë identiteti), sms të shkëmbyera me përfaqësuesen e emisionit, vendim gjykatë etj. Gjithashtu pala ankuese ka cituar edhe linkun ku është e publikuar videoja e seancës së ndërmjetësimi (në rrjetet sociale YOUTUBE dhe FACEBOOK) duke kërkuar edhe fshirjen e saj.

"KLAN TV" në kuptim të të Ligjit nr. 9887, datë 10/03/2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale" i ndryshuar, është kontrollues privat i cili kryen aktivitetin e tij në fushën e medias audiovizive, dhe në këtë kuadër, për realizimin e veprimtarisë përpunon të dhëna personale.

- Në kuadër të trajtimit të ankesës Zyra e Komisionerit konstatoi se kontrolluesi "KLAN TV" në rubrikën "Shihemi në Gjyq" (drejtuar nga Znj. Eni Çobani) të emisionit "E diela

Shqiptare”, të datës 17.04.2016, ka publikuar të dhëna (informacione, fakte dhe rrethana) lidhur me palën ankuese me iniciale E.M (të cilat mund ta bëjnë të identifikueshme), pa marrë pëlqimin e saj, në zbatim të nenit 6/1/a të Ligjit nr. 9887, datë 10/03/2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale” i ndryshuar dhe pikës 9 të Kreut I të Udhëzimit nr. 9, datë 15.09.2010 “Për rregullat themelore në lidhje me mbrojtjen e të dhënave personale në median e shkruar, vizive dhe audiovizive”, i ndryshuar.

Konkretisht, nga analizimi i seancës së ndërmjetësimit nuk është përmendur emri i ankueses dhe as i bashkëshortit të saj por është publikuar se:

- Ka njohuri në fushën e ndërtimit;
- Është kumatë e bashkëshortit të çiftit;
- Dysohet për lidhje intime (kjo është jashtë objektit të punës së Komisionerit);
- Fakte dhe rrethana mbi ngjarjen/konfliktin civil.

Zyra e Komisionerit vlerëson se pavarësisht mos publikimit të emrit të palës ankuese, faktet dhe rrethanat e publikuara gjatë emisionit e bëjnë atë të identifikueshëm (duke marrë parasysh edhe faktin që qyteti ku banojnë është i vogël) duke rrezikuar privatësinë e individit.

Kontrolluesi nuk është në gjendje që të provojë marrjen e pëlqimit të ankuesit për përpunimin e të dhënave të tij, sipas nenit 3 pika 24 të ligjit nr. 9887, datë 10/03/2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale” i ndryshuar, duke vepruar në kundërshtim me nenin 6 pika 1/a të këtij ligji.

Zyra e Komisionerit vlerëson se ekzistenca e pëlqimit të palëve që marrin pjesë në një seancë ndërmjetësimi dhe personave të tretë (rasti i ankuesit) të dhënat e të cilëve publikohen gjatë seancës, është e vetmja mundësi ligjore e kontrolluesit, referuar nenit 6 të ligjit nr. 9887, datë 10/03/2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale” i ndryshuar, për të legjitimuar përpunimin e të dhënave personale. Pëlqimi, në bazë të nenit 3 pika 24 të ligjit, “*duhet të jetë në formën e një deklarate me shkrim, i dhënë shprehimisht me vullnet të plotë e të lirë dhe duke qenë në dijeni të plotë për arsyen pse të dhënat do të përpunohen, çka nënkupton që subjekti i të dhënave pranon që të përpunohen të dhënat e tij*”.

Veprimtaria e ndërmjetësimit dhe dokumentet apo të dhënat personale që përpunohen gjatë kryerjes së saj sanksionohet në Ligjin nr. 10385, datë 24.02.2011 “Për ndërmjetësimin dhe zgjidhjen e mosmarrëveshjeve” dhe në këtë kuadër përpunimi konsiderohet i ligjshëm. Megjithatë publikimi i seancave të ndërmjetësimit në media, është një qëllim i ri që konsiderohet në tejkalim të qëllimit të përpunimit që parashikon ligji. Në këtë kuadër pëlqimi i subjekteve të përfshira në ndërmjetësim është mjaft i rëndësishëm për të garantuar ligjshmërinë e këtij përpunimi të ri që ligji nuk e parashikon (publikimi në media). Në mungesë të pëlqimit përpunimi do të konsiderohej i paligjshëm.

- Zyra e Komisionerit gjatë hetimit administrativ konstatoi se kontrolluesi “**KLAN TV**”, në kuadër të emisionit “Shihemi në Gjyq”, zbaton një praktikë për marrjen e pëlqimit të qartë dhe të shprehur të të gjitha palëve që marrin pjesë në seancat e ndërmjetësimit, nëpërmjet aplikimit të “*Deklaratës për dhënien e pëlqimit për të dhënat personale*”.

Nëpërmjet kësaj deklarate kryhet edhe informimi për subjektet e të dhënave personale (palët pjesëmarrëse në procesin e ndërmjetësimit), mbi qëllimin dhe mënyrën e përpunimit të të dhënave, për të drejtën për akses, të drejtën për korrigjim të të dhënave personale të tyre, dhe të drejtat e tjera, në zbatim të nenit 18 të Ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”, i ndryshuar.

- Kontrolluesi ka hartuar një “Rregullore për mbrojtjen, përpunimin, ruajtjen dhe sigurinë e të dhënave personale” në të cilën parashikohen rregulla specifike mbi mënyrën e përpunimit të të dhënave personale, sigurinë e të dhënave, afatet e mbajtjes së të dhënave, të drejtat e subjekteve etj, në zbatim të nenit 27 të Ligjit nr. 9887, datë 10/03/2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale” i ndryshuar.

Zyra e Komisionerit vlerëson se hartimi i rregullores është i rëndësishëm për kontrolluesin pasi përbën bazën e referimit për çdo përpunim të të dhënave, për çdo pjesëmarrës në seancat e ndërmjetësimit dhe punonjësit, dhe përcakton standardet ligjore për garantimin e një përpunimi të ligjshëm dhe të sigurtë të të dhënave personale.

Për shkeljet e konstatuara është mbajtur procesverbali i konstatimit në momentin e ushtrimit të hetimit administrativ (që mban datën 27.05.2016).

Në përmbajtje të procesverbalit, përfaqësuesi i kontrolluesit, deklaroi: “Unë D.Ç, si përfaqësuese e kontrolluesit kërkoj që të na lihet afat që brenda datës 02.06.2016 të paraqesim me shkrim pretendimet tona lidhur me rastin në hetim administrativ”. Një kopje e procesverbalit iu dorëzua kontrolluesit.

Në vijim, në datën 13.06.2016 (ora 10:30) u zhvillua seanca dëgjimore në të cilën përfaqësuesja e autorizuar e kontrolluesit paraqiti në formë shkresore të gjitha pretendimet dhe bashkëlidhur dorëzoi në cilësinë e provës:

- “Rregullore për mbrojtjen, përpunimin, ruajtjen dhe sigurinë e të dhënave personale”;
- “Deklaratë për dhënien e pëlqimit për të dhënat personale”;
- “Kontratë shërbimi midis kontrolluesit” “*KLAN TV*” dhe *Znj. Eni Shehu (Çobani)*;

Lidhur me pretendimet e kontrolluesit Zyra e Komisionarit vlerëson se pavarësisht marrëdhënies kontraktore që ekziston midis kontrolluesit “*KLAN TV*” dhe *Znj. Çobani* (në cilësinë e përpunuesit), në bazë të ligjit nr. 9887, datë 10/03/2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale” i ndryshuar, në çdo rast është kontrolluesi përgjegjës për garantimin e përpunimit të ligjshëm të të dhënave personale dhe mbrojtjes apo sigurisë së tyre. Marrëdhënia kontraktore zgjidh pasojat juridike civile midis palëve dhe shpreh vullnetin e tyre të lirë. Në këtë kuadër kontrolluesi “*KLAN TV*” nuk mund të shmanget nga garantimi dhe plotësimi i detyrimeve të sanksionuara në ligjin nr. 9887, por duhet të marrë të gjitha masat teknike organizative për të realizuar qëllimin e ligjit.

Sa më sipër,

Në zbatim të neneve 29, 30, 31 pika 1/ “a/1” dhe 32/1 të Ligjit nr. 9887, datë 10/03/2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale” i ndryshuar,

REKOMANDOJ:

1. Në zbatim të nenit 6/1/a të Ligjit nr. 9887, datë 10/03/2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”, i ndryshuar, të tregohet kujdes lidhur me marrjen e pëlqimit paraprak dhe në formë shkresore të palëve pjesëmarrëse në seancat e ndërmjetësimit dhe të palëve të treta të përfshira (në rastet kur është e nevojshme). Në mungesë të dhënies së pëlqimit të mos publikohen fakte dhe rrethana që i bëjnë të identifikueshëm.

2. Në zbatim të nenit 19 të Ligjit nr. 9887, datë 10/03/2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”, i ndryshuar, seanca e ndërmjetësimit e transmetuar në rubrikën “Shihemi në Gjyq” (drejtuar nga Znj. Eni Çobani) në emisionin “E diela Shqiptare” (e datës 17.04.2016), duhet të fshihet nga të gjitha mediat dhe rrjetet sociale ku është publikuar (Youtube dhe Facebook);
3. Në zbatim të nenit 32/1 të Ligjit nr. 9887, datë 10/03/2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”, i ndryshuar, të kryhet plotësimi i detyrimeve të parashikuara në pikën 2 të këtij Rekomandimi, brenda një afati 30 ditor nga momenti i marrjes dijeni. Pas këtij afati të njoftohet me shkrim pranë Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale mbi masat e marra në zbatim të Rekomandimit të mbështetura nga aktet përkatëse.
4. Plotësimi i këtyre detyrimeve ligjore mund të jetë objekt kontrolli në vazhdimësi nga Zyra e Komisionerit.
5. Në rast mos përmbushje të këtyre detyrimeve, Komisioneri vepron sipas nenit 30, pika 2 të Ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”, i ndryshuar. Komisioneri në rast shkeljesh serioze, të përsëritura ose të qëllimshme të ligjit nga një kontrollues ose përpunues, veçanërisht, në rastet e përsëritura të moszbatimit të rekomandimeve të tij, vendos sanksion me gjobë për kundërvajtjet administrative dhe e denoncon publikisht ose e raporton çështjen në Kuvend dhe në Këshillin e Ministrave.

Ky Rekomandim u shpall sot më datë 28/6 /2016

